



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 30.07.2013

Nr. 0204 - 987

**PËR:** Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes  
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

**LËNDA:** KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, Npi. 01/162, Pranuar me datë, 24.07.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Npi. 01/162, të miratuar me datë 01.07.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Npi. 01/162 për ndarjen e 4 hektarëve sipërfaqe për varrezat e Komunës së Shtimes.

Me respekt,

Slobodan Petrović,  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 30.07.2013  
br. 0204 - 987

**Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik opštine Štimlje**  
**Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine opštine Štimlje**

**Predmet: Ptvrdra zakonitosti odluke opštine Štimlje,**  
**Npi. 01/162, Primljeno dana , 24.07.2013**

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke Npi. 01/162, odobreno dana 01.07.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka Npi. 01/162 o,dodeli 4 hektara površine za goblje opštine Štimlje.

Sa poštovanjem.

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

**Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a**  
**Rukovodiocima odeljenja MALS-a**  
**Arhivi MALS-a.**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL-SHTIME**  
**01Nr.006/4728, Datë: 25.6.2013**



Npi – 01/162, Datë: 1.7.2013

Kuvendi Komunal – Shtime shqyrtoi kërkesën 01Nr.016/2573, datë: 23.5.2013, të Imamit të Xhamisë së vjetër në Shtime z.Isa Tërshani, i cili në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, dega në Shtime, ka paraqitur kërkesë me të cilën ka kërkuar që Kuvendi Komunal, të ndajë një Lokacion për varrezat e qytetit të Shtimes. Propozojmë që lokacioni të ndahet afër varrezave të vjetra duke përfshi një hapsirë rreth 5 (pesë) hektarëve sipërfaqe, ose në ndonjë vend tjetër të propozuar nga Komuna. Kjo çështje duhet të zgjidhet sepse në varrezat e vjetra nuk na ka mbet hapësirë e mjaftueshme.

Kuvendi Komunal-Shtime, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDARJEN E 4 HEKTARËVE SIPËRFAQE PËR VARREZAT E SHTIMES**

**I**

Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e gjashtë, të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën 1.7.2013, me shumicën e votave ka vendosur që të aprovi kërkesën me numër 01Nr.016/2573, të Imamit z.Isa Tërshani, për ndarjen e 4 (katër) hektarëve sipërfaqe të pronës Komunale e cila do të mbetet sipërfaqe e caktuar për Varreza të Qytetit të Shtimes, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 1404/1, në Zonën Kadastrale-Shtime, e cila evidentohet pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

**II**

A r s y e t i m: Kuvendi Komunal – Shtime, kërkesën e palës e ka aprovuar duke u bazuar në rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi me arsyetimin e bazuar në Planin Urban të Komunës së Shtimes.

**III**

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

**IV**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Kryetarëve të Bashkësive të Shtimes, dhe Imamit të Xhamisë së vjetër në Shtime.



Kryesuesi Kuvendit  
Kujtim Xhelili